



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-I-19-0010

Paditësi

F.Sh., me vendbanim, Londër, Britani e Madhe. Të cilin e përfaqëson avokat.

Vs.

E paditura

Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP), “Agim Ramadani “ nr. 23, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Sylejman Shumolli gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 10 tetor 2019, me shumicë të anëtarëve, merr këtë:

AKTVENDIM

- 1. Refuzohet kërkesa e paditësit për lëshimin e masës së sigurisë.**
- 2. Nuk ngarkohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 17 shtator 2019, paditësi parashtrij padi me propozim për lëshimin e masës së sigurisë pranë DHPGJS.

Paditësi në padinë e tij pohon se ishte shpallur ofertuesi me çmimin më të lartë të ofertuar për blerjen e njësisë nr. 30 – Kooperativa Bujqësore “P”, ngastra kadastrale nr. P-702020053-00240-0, zona kadastrale P, shitja e aseteve vala 46 (tani e tutje TENDERI).

Paditësi pohon se me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP, të datës 24 maj 2019, është anuluar tenderi (tani e tutje VENDIMI).

Paditësi tani me padi kërkon si në vijim:
- Anulimin e Vendimit;

- Konfirmimin që paditësi të shpallet fitues i Tenderit dhe që të obligoj të paditurën të lidhë Kontratë mbi shitblerjen të pronës, objekt i tenderit;
- Kompenzimin për dëm material; dhe
- Kompenzimin e shpenzimeve procedurale.

Paditësi me padi propozon lëshimin e masës së sigurisë (MS) me të cilën do të obligohet e paditura që pronë objekt të tenderit, mos ta shes, ta ngarkojë me ndonjë barre reale si dhe cilën do formë tjetër të tjetërsimit si dhe në të ardhmen mos të hap tender gjer në vendimin përfundimtar nga ana e Gjykatës.

Padisë i janë bashkangjitur:

- Kopja e njoftimi mbi anulimin e Tenderit, i datës 7 qershiro 2019.
- Kopja e njoftimit mbi shpalljen e ofertuesit me çimimin më të lartë, të datës 13 maj 2019
- Kopja e njoftimit, drejtuar AKP, mbi qëllimin e paditësit për të ushtruar padi kundër Vendimit.
- Kopja e kërkesës së paditësit për dorëzimin e Vendimit.
- Kopja e Memorandumit mbi informimin për shitjen e aseteve.
- Kopja e rezultateve mbi ofertat, e datës 8 maj 2019.

Me urdhërin e datës 18 shtator 2019, padia së bashku me MS, ju dorëzua të paditurës.

AKP me 24 shtator 2019, parashtror përgjigjen e saj ndaj kërkesës për MS.

AKP pohon se kërkesa nuk i plotëson kriteret ligjore, të parapara sipas nenit 61 të Shtojcës së ligjit mbi nr. 06/L-086 për DHPGJS (tani e tutje: LDHP). Andaj, AKP propozon që MS ta hudhë si të papranueshëm ose refuzoj si të pabazuar.

Arsyetimi ligjor:

Në pajtim të nenit 61.1 të LDHP mund të nxjerrë MS me kusht që parashtruesi të jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet një MS. Sipas nenit 61.1, dëmi konsiderohet si i ‘pariparueshëm’ vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Për më tepër padia do të konsiderohej si e bazuar.

Andaj pala duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të menjëhershëm dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kriteret janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet. Barra e provave bien mbi paditësit.

Pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata konstaton se në këtë rast, paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin MS. Paditësi nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrorë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i riparueshëm do të shkaktohej në qoftë se MS nuk do të lëshohej.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet

Paditësi ka paguar taksat gjyqësore.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Afati i përcaktuar kohor fillon në mesnatën e ditës, kur pala përkatëse ka marrë vendimin me shkrim. Ankesa së bashku me Aktvendimin e ankimuar duhet gjithashtu të dorëzohet tek palët tjera nga Ankuesi, brenda të njëjtit afat kohor.

Në pajtim me nenin 9 paragrafi 8 i Ligjit për DHPGJS, në rast se pala parashtron ankesën, pala tjetër e procedurës mund të dorëzojë përgjigje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, që nga data e dorëzimit të apelit tek ajo, duke parashtruar përgjigjen tek ankuesi dhe palëve tjera (nëse ka),

Siç përcaktohet në nenin 68 paragrafi 1.2, lidhur me nenin 38.3 të Ligjit për DHPGJS, parashtruesi i ankesës ka shtatë (7) ditë afat, pas dorëzimit të përgjigjejes ndaj ankesës së tij, të parashtrrojë përgjigjen e tij ndaj asaj përgjigjeje tek Kolegji i Apelit dhe ta dorëzojë atë tek pala tjetër.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Sylejman Shumolli, Gjyqtar
